


# PARIMET E MBROJTJES SË TË DHËNAVE TË CANON

MBROJTJA DHE PRIVATËSIA E TË DHËNAVE

Canon



## DREJTËSIA DHE TRANSPARENCA

Canon përpunon të dhënat personale në mënyrë të drejtë dhe u ofron individëve informacione se si dhe pse të dhënat e tyre përpunohen me anë të deklaratës sonë të privatësisë.



## PËRPUNIM LIGJOR

Canon përpunon të dhënat personale vetëm kur ka një bazë ligjore të vlefshme për ta bërë këtë.



## KUFIZIMI I QËLLIMIT

Canon mbledh të dhëna personale vetëm për një qëllim specifik, të qartë dhe legjitim. Çdo përpunim i mëvonshëm bëhet vetëm nëse është për një qëllim të përputhshëm, përveç rastit kur merret pëlqimi i individit ose përpunimi lejohet ndryshe me ligj.



## MINIMIZIMI I TË DHËNAVE

Canon përpunon të dhëna personale që janë të përshtatshme, relevante dhe të kufizuara në atë që është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur.



## SAKTËSIA E TË DHËNAVE

Canon merr hapa të arsyeshëm për të siguruar që të dhënat personale të jenë të sakta, të plota dhe të përditësuara.



## TË DREJTAT INDIVIDUALE

Canon respekton të drejtat e individit në lidhje me të dhënat e tyre personale, duke përfshirë të drejtat e tyre të aksesit, fshirjes, korigjimit, transferimit dhe refuzimit.



## KUFIZIMI I RUAJTJES

Canon ka politika dhe standarde të vendosura që kërkojnë që biznesi t'i ruajë të dhënat vetëm për aq kohë sa është e nevojshme.



## SIGURIA E TË DHËNAVE

Canon përdor masat e duhura të sigurisë për të mbrojtur të dhënat personale gjatë gjithë ciklit jetik të të dhënave dhe kërkon të njëjtin standard nga përpunuesit e vet.



## KUJDESJA

Canon ka politika dhe praktika të përshtatshme për administrimin e sigurt të të dhënave personale që përpunon.



## PËRGJEGJËSIA

Canon përputhet me parimet e mbrojtjes së të dhënave dhe mund të demonstrojë pajtueshmëri me këto parime.